



**RAPORTI TREMUJOR I MAMOGRAFISË MOBILE**  
**PROJEKTI “MA-MO”**



**Nga: Dr.Ardian Biçaku<sup>1,2</sup>**

<sup>1</sup>SHSKUK/QKUK Klinika e Radiologjis, Prishtinë

<sup>2</sup>Koordinator i Mamografisë Mobile në SHSKUK

**Periudha e raportimit: 01 Janar – 31 Mars, 2015**

**Prill, 2015**

## RAPORTI TREMUJOR PËR MAMOGRAFINË MOBILE RAPORTI PËR PERIUDHËN TREMUJORE JANAR-MARS 2015

Deri më 31 Dhjetor 2014 me Mammograf Mobil janë ekzaminuar 260 pacientë.


Prej 1 Janari deri më 23 Shkurt 2015 për shkak të temperaturave të ulta me mamograf mobil është punuar në hapësirat e QKUK-së dhe kryesisht pacientët e QKUK-së. Gjithashtu, në kuadër të sensibilizimit të popullatës për ekzaminime mamografike janë ekzaminuar në mënyrë të organizuar femrat e organizatave të ndryshme si: të policisë së Kosovës, obduspersonit etj., dhe deri më 23 Shkurt 2015 janë ekzaminuar 130 femra.

Me 24 Shkurt Mamografi mobil për herë të parë fillon punën në terren, duke filluar në Komunën e Gjilanit, përkatësisht në fshatin Zhegër, pastaj Dobercan, Perlepnice dhe Gjilan.

Gjatë kësaj periudhe tremujore Janar-Mars janë regjistruar 44 ditë pune me mamograf mobil dhe janë ekzaminuar 366 femra (mesatarisht 8.3 pacientë në ditë pune). 130 pacient ne QKUK dhe 236 ne terren.

Janar	74 femra
Shkurt	119 femra (56 ne QKUK dhe 63 ne terren – Zheger/Gjilan)
Mars	173 femra

Vërehet rritje e vazhdueshme e kapaciteteve të punës dhe si objektiv është të realizohen 15 ekzaminime në ditë që paraqet 10% të kërkesave të screening mamografisë.



Për realizimin e punës janë angazhaur stafi i QKUK-së i përbërë nga 6 radiolog, 4 teknik të radiologjisë, 2 inxhinjer, 1 shofer, si dhe stafi i SR të Gjilanit (radiologët dhe teknikët e radiologjisë).

Stafi i Mamografisë mobile deri me 31 Mars, ka rrugëtuar mbi 3000km.